


### Detyra 1: Simulimi i hedhjes së dy zareve në Excel (5 pikë)

Detyrën do ta dorëzoni deri në datën dd prill vvvv ora xx:00 me email. (para laboratorit 3)


Detyra ka për qëllim që të mësoni të ndryshoni madhësinë e shkronjave, stilet e shkronjave, të vendosni vija, korniza (border), të ndryshoni ngjyrat e sfondit, përdorimin e funksioneve të gatshme si dhe kushtin if, etj., duke automatizuar në Excel hedhjen e dy zareve.

1. Zgjidhni qelizat B2:J9. Ngjyrojeni me të gjelbër dhe me kornizë të zezë.
2. Vendos funksionin RANDBETWEEN(1,6) në qelizën C2.
3. Në qelizat C3 dhe E5 shkruani formulat që nëse rrokullisim zaret dhe kemi vlerat 2, 3, 4, 5 ose 6, këto qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Pika përftohen me germën l (L e vogel), në fontin Wingdings dhe madhësi 28. Formula përmban funksionin if, operatorin logjik or, kushtet logjike përbëhen nga C2=2, C2=3, C2=4, C2=5, C2=6, vlera kur kushti është i vërtetë është "l", vlera kur është i gabuar është bosh "" . Ngjyrojeni fushën me të verdhë.
4. Në qelizat C5 dhe E3, shkruani formulat që nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerat 4, 5 ose 6, këto qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Pika përftohen me germën l (L e vogël), në fontin Wingdings dhe madhësi 28. Formula përmban funksionin if, operatorin logjik or, kushtet logjike C2=4, c2=5, C2=6, vlera kur kushti është i vërtetë është "l", vlera kur kushti është i gabuar është bosh " ". Ngjyrojeni me të kuqe.
5. Në qelizat C4 dhe E4, shkruani formulën që, nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerën 6, këto qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Pika përftohen me germën l (L e vogël), në fontin Wingdings dhe madhësi 28. Formula përmban funksionin if, operatorin logjik or, kushtin logjik C2=6, vlera kur kushti është i vërtetë është "l", vlera kur kushti është i gabuar është bosh " ". Ngjyrojeni me blu.
6. Në qelizën D4, shkruani formulën që nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerën 1,3,5 qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Pika përftohen me germën l (L e vogël), në fontin Wingdings dhe madhësi 28. Formula përmban funksionin if, operatorin logjik or, kushtet logjik C2=1, C2=3, C2=5, vlera kur kushti është i vërtetë është "l", vlera kur kushti është i gabuar është bosh " ". Ngjyrosini me gri.

Pasi të keni mbaruar të gjithë hapat, rezultati në Excel është si më poshtë:




7. Kopjoni zonën C2:E5 dhe paste tek G2:I5. Mbasi të keni mbaruar kopjimin, rezultati në Excel është si më poshtë:




8. Ndryshoni ngjyrën e shkronjave të qelizës C2 dhe qelizës G2 në të gjelbër.  
 9. Zgjidhni qelizat C3:E5. Ngjyrojeni me të bardhë dhe me kornizë të zezë.  
 10. Zgjidhni qelizat G3:I5. Ngjyrojeni me të bardhë dhe me kornizë të zezë.

Mbasi të keni mbaruar formatimin rezultati në Excel është si më poshtë:



11. Për të vendosur një buton komandë fillimisht duhet të aktivizoni developer tek **File/ Options/ Customize Ribbon**, klikoni tek developer në menynë **Main Tabs** dhe shtypni **OK**.
12. Më pas tek menya Developer, zgjidh tek Controls, insert Controls, Form Controls, Button dhe vendoseni në Excel (drag e drop).
13. Ndryshoni emrin nga button 1 në **Hidhni Zaret**.
14. Klik me të djathtën e mausin mbi butonin e vendosur dhe zgjidhni **assign Macro**. Zgjidh butonin Edit dhe shkruaj në editorin që ju del **sheet1.calculate**, si në figurën e mëposhtme:



15. Detyrën ruajeni me emër: Detyrë1\_Emër\_Mbiemër duke zgjedhur tipin e filet excel macro-enabled workbook.
16. Rezultati në fund duhet t'ju dalë si më poshtë:

